



Si të bëni Biznes  
në Tiranë



# Si të bëni biznes në Tiranë

## PËRMBAJTJA

### TIRANA ME NJË KËNDVËSHTRIM

Karakteristika konkurruese që dallojnë Tiranën

Kryeqytet dhe qendra më e madhe urbane e vendit

Model i një ndryshimi të suksesshëm strukturash

Qytet afër Durrësit, portit më të madh shqiptar në Adriatik

Qyteti me të vetmin aeroport ndërkombëtar në vend

Qyteti i universiteteve

### KU ËSHTË FOKUSUAR EKONOMIA E TIRANËS

Qyteti ku janë investuar 50% të kapitaleve të huaja

Qyteti i një bume të paparë të industrisë së ndërtimit

Destinacion i përhershëm i të gjithë turistëve në Shqipëri

Qyteti i qendrave më të mëdha tregtare në vend

Qendër aktivitetesh

### HAPJA E NJË BIZNESI TË RI

Rregullat e emigrimit dhe qëndrimit për të huajt

Hapja e një biznesi

Ndihma që ofrohet për këtë qëllim

Sistemi bankar

Sigurimi shëndetësor

Sa kushton blerja e pronave

Taksat

Kualifikimi i fuqisë punëtore

Sigurimi i fuqisë punëtore

Marrja e njerëzve në punë dhe pagat

Importimi dhe eksportimi i mallrave

### MJEDISI I BIZNESIT

Transferimi i të dhënave dhe komunikacioni

Furnizimi me energji elektrike, ujë dhe ndotja e ajrit

Cilësia e shërbimit shëndetësor


Hotele dhe apartamente në Tiranë

Komuniteti ndërkombëtar

Shkollat

Ndihmë dhe konsulencë në Tiranë

Burimet e informacionit në internet



**BASHKIA TIRANE**  
DREJTORIA E PROMOVIMIT TË QYTETIT

Mbështetje e zhvillimit ekonomik lokal  
Promovimi Tiranës si destinacion biznesi dhe turizmi  
Mbështetje dhe informacion për investitorët  
Ndërtimi i rrjetit ndihmës për biznesin  
Mbështetje për bizneset e reja dhe innovative

Adresa: Rr. "Ded Gjo Luli", Tiranë, Shqipëri  
Tel: + 355 4 222 3313  
E-mail: [contactled@tirana.gov.al](mailto:contactled@tirana.gov.al)  
Internet: [www.tirana.gov.al](http://www.tirana.gov.al)

### PËRGGATITUR NGA DREJTORIA E PROMOVIMIT TË QYTETIT, BASHKIA E TIRANËS.

Drejtorja e Promovimit të Qytetit të Tiranës ka për qëllim promovimin e Tiranës si një mjedis të favorshëm për biznes dhe destinacion turistik. Drejtorja mund të kontaktohet: [contactled@tirana.gov.al](mailto:contactled@tirana.gov.al)

### Personeli redaktorial:

Sokol Mici, përgjegjës i Sektorit të Vlerave Ekonomike; Afërdita Tafa, përgjegjëse e Zyrës së Turizmit; Mira Haxhiu, specialiste; Klodian Gjata, specialist.

Botuesit janë përpjekur me të gjitha mundësitë që informacioni që ofron kjo broshurë të jetë sa më aktual dhe sa më korrekt. Megjithatë nuk mund të jepet asnjë garanci që ky informacion është i plotë dhe qind për qind i saktë. Botuesit nuk janë përgjegjës për përmbajtjen e faqeve në internet adresat e të cilave janë dhënë këtu.



## TIRANA ME NJË KËNDVËSHTRIM

### Tirana – Kryeqytet dhe qendra më e madhe urbane e vendit

Tirana, kryeqyteti i Shqipërisë, me një sipërfaqe prej rreth 42 km katrorë, është qyteti dhe qendra më e madhe ekonomike, administrative, politike, sociale dhe kulturore e vendit.

Megjithatë qyteti sot është zgjeruar përtej kufijve të tij administrativ duke krijuar një entitet të vazhdueshëm, i cili përfshin komunat dhe bashkitë e Farkës, Dajtit, Poskuqanit, Kamzës, Kasharit dhe Vaqarrit.

Tirana ndodhet në qendër të territorit të Shqipërisë. Qendra e qytetit është 110m mbi nivelin e detit. Temperatura mesatare vjetore është 17°C.

Sipas të dhënave zyrtar populllia e Tiranës është dyfishuar gjatë viteve të fundit duke kapur shifrën prej rreth 617,000 banorë. Sipas përllogaritjeve të bëra mendohet se në vitin 2020 popullsia e Tiranës do të jetë rritur me 400 000 banorë.

Sot në Tiranë jeton rreth 19.5 % e popullsisë së përgjithshme të vendit, ndërsa qarku i Tiranës sipas INSTAT-it në vitin 2007 kishte një potencial njerëzor prej rreth 804,000 ose rreth 25% të popullsisë së përgjithshme të vendit. Popullsia e qytetit të Tiranës përbën rreth 77% të popullsisë së Qarkut.

Me rreth 226,000 forca pune Tirana ofron rreth 23% të forcave të përgjithshme të punës në vend. Kjo gjë e bën metropolin e Tiranës të krahasueshëm në Ballkan, Evropë e më gjerë. Forcat e punës në Qarkun e Tiranës përbëjnë rreth 31% të popullsisë së Vendi.

Në Tiranë kanë selitë e tyre të gjitha institucionet kryesore të vendit si presidenca, parlamenti, qeveria, pothuajse të gjitha përfaqësitë diplomatike të akredituara në Shqipëri si dhe shumë organizata ndërkombëtare si: Banka Botërore, ([www.worldbank.org/albania](http://www.worldbank.org/albania)) FMN, ([www.imf.org](http://www.imf.org)), PNUD, ([www.undp.org.al](http://www.undp.org.al)), UNESCO etj.

Tirana ofron kushtet më të mira të jetesës në Shqipëri, nivelin më të lartë të qetësisë dhe sigurisë në vend.

Në Tiranë gjenden forcat më të kualifikuara të punës në Shqipëri.

Metropoli shqiptar është qyteti me numrin më të madh të shkollave të të gjitha niveleve dhe llojeve.

Për shkak të pozicionit të saj gjeografik si dhe aksesit të favorshëm ndaj tregut europian, Tirana është vend ideal për të filluar një biznes.

Infrastruktura ndihmëse shumë e mirë e Tiranës e bën atë një platformë perfekte për lançimin e ndonjë biznesi ose aktiviteti privat në rajon.

### Tirana – Model i një ndryshimi të suksesshëm strukturash

Me ekspertizë dhe kreativitet Tirana ka mundësuar ndryshime të mëdha strukturore.

Investitorët që kërkojnë një vendndodhje me perspektivë për bizneset e tyre do të gjejnë kushte shumë të mira në Tiranë.

Iniciativat në rritje të ndërrmarra nga Bashkia dhe industritë lokale janë bashkërenduar në të njëjtën kohë me stimulimin e mjedisit të biznesit.

Qeverisja e mirë dhe modernizimi i administratës së qytetit nxisin investimet dhe i bëjnë ato më të sigurta duke ofruar një klimë shumë të favorshme për biznesin.

Për këtë arsye kryebashkiaku i Tiranës, Edi Rama, është Best World Mayor 2004, çmim i akorduar nga City Mayors.

Zoti Rama u votua për këtë çmim për qeverisje të mirë të qytetit, jo vetëm nga komuniteti i kryeqytetit, por edhe nga mijëra e mijëra votues në vende të tjera europiane dhe në Amerikën e Veriut.

Në 2009, në Samitin Botëror të Kryeqyteteve të Ardhshëm në Abu Dhabi, Edi Rama u nderua si një nga Njerëzit me Inovativ në Botë, në kategorinë e çmimeve për "Transformimin e qyteteve".

Në shkurt të vitit 2007, në Shqipëri u zhvilluan zgjedhjet për organet e pushtetit vendor. Në këto zgjedhje Z. Edi Rama u rizgjodh për të tretën herë radhazi në krye të Bashkisë së Tiranës.



Në Tiranë operojnë aktualisht rreth 21,000 biznese të vegjël të mëdhenj, dhe VIP, vendas dhe të huaj.

Në këto katër vitet e fundit numri i bizneseve në Tiranë është rritur me rreth 8,700 nga rreth 12,300 biznese që ishin në vitin 2004. Në Tiranë operojnë 39% e biznese të regjistruar në Shqipëri.

90% e kompanive më të mëdha të vendit dhe më se 80% e kompanive të huaja apo joint ventures janë vendosur në Tiranë.

Kompani të tilla si DHL, UPS, Deloitte & Touch, AMC, Vodafone, Coca-Cola, Aquila Liquori, Tirana Internacional AirPort, Blackwell Consultig, Uniqa Group, Aspis Group etj. Banka të ndryshme si ato Amerikane, Gjermane, Italiane, Greke dhe Austriake kanë filialet e tyre në Tiranë. Këto kompani kanë investuar një pjesë të konsiderueshme të kapitalit të tyre në Tiranë.

Në Shqipëri operojnë tre kompani të telefonisë celulare: AMC, Vodafone dhe Eagle Mobile. Një kompani e katërt do të hyjë së shpejti në këtë treg.

Këto kompani kanë më tepër se 2,2 milion abonentë dhe me shërbimet e tyre mbulojnë rreth 85% të territorit të vendit.



Pas një viti tranzicioni për shkak të privatizimit dhe evidentimit të gjendjes reale nga kompanitë "Calik" dhe "Turk Telekom", "Albtelecom", kompania shtetërore e telefonisë fikse, 76 % të aksioneve të së cilës janë shitur për 120 milionë euro, tashmë e ka fokusuar punën në përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjet të saj në të gjithë vendin.

Ligji Nr. 9663, datë 18.12.2006, "Për Koncesionet" mundëson krijimin e kuadrit të nevojshëm për nxitjen dhe lehtësimin e zbatimit të projekteve koncesionare, të financuara nga sektori privat duke rritur kështu transparencën, barazinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike.

Industria e lehtë në rajonin e Tiranës është sektori i industrisë prodhuese më i zhvilluar për sa i përket kontributit që jep në PPB në shkallë vendi.

Në qarkun e Tiranës përpunohet 44 % e miellit, 18 % e qumështit, 50 % e sallamrave, 49 % e konservave të perimeve dhe frutave, 78 % e birrës, 61 % e pijeve alkoolike dhe freskuese, dhe 76 % e vajrave ushqimore.

Zhvillimi i kësaj industrie në qarkun e Tiranës kushtëzohet në masën më të madhe nga lehtësirat e zhvillimit të biznesit në kryeqytet.

Këto kompani dhe industri si dhe performanca e orientuar drejt sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme me përqendrimin e tyre në tregti dhe shërbime, përfaqëson karakterin modern të qytetit dhe rajonit të Tiranës.



## Qytet afër Durrësit, portit më të madh shqiptar në Adriatik

Tirana ndodhet vetëm 41 km larg Durrësit, qytetit me portin më të madh shqiptar në detin Adriatik për mallra dhe pasagjerë ([www.apdurre.com.al](http://www.apdurre.com.al)).

Të dy qytetet i lidh një autostradë e ndërtuar vitet e fundit që ka shkurtuar shumë kohën e udhëtimit.

Nga porti i Durrësit kalojnë rreth 85% e import-eksporteve shqiptare duke përpunuar mijra ton mallra si dhe një numër të konsiderueshëm pasagjerësh në vit.

Një numër i madh tragetesh nga Italia, Sllovenia, Kroacia dhe Greqia hyjnë në kalatën e këtij porti çdo ditë.

BERZH i ka dhënë Portit të Durrësit një hua prej 14 milion Euro për të ndërtuar një terminal të ri për tragetet si dhe për të rehabilituar dy kalat për të përmirësuar shërbimet ndaj pasagjerëve dhe ngarkesave.



Ky projekt bashkëfinancohet me Bankën Europian të Investimeve. Projekti do të ndihmojë për të përmirësuar transportin ndërmjet Shqipërisë dhe fqinjëve të saj evropian duke përmirësuar sidomos lidhjet me vende të tilla si Italia, Kosova, Maqedonia dhe Bullgaria. Nga kjo do të përfitojnë si bizneset ashtu edhe turizmi.

## Qyteti me të vetmin aeroport ndërkombëtar në vend

Tirana ndodhet 20 km larg aeroportit ndërkombëtar "Nënë Tereza" ose Rinas, aeroportit të vetëm ndërkombëtar të Shqipërisë ([www.tirana-airport.com](http://www.tirana-airport.com)).



Ky aeroport është nyja më e rëndësishme ajrore lidhëse me botën. Ai gjendet vetëm 20 minuta larg nga qendra e Tiranës. Aeroporti ofron një shërbim të shpejtë të transportit të udhëtarëve dhe mallrave.

Në gjysmën e parë të 2008 aeroportit u shërbeu rreth 541,000 pasagjerëve. Ky numër është 19% më i madh se ai së njëjtës periudhë të 2007-ës.

Ky aeroport i ristrukturuar ka filluar nga puna në mars të 2007-ës. Për 20 vitet e ardhshme aeroporti do të menaxhohet nga Tirana Airport Partners një konsorcium i përbërë nga DEG (Deutsche Investitions Entwicklungsgesellschaft) dhe Fondin Amerikan i Ndërmarrjeve.

Në korrik 2008 aeroporti "Nënë Tereza" filloi punimet për të rritur kapacitetin e terminalit të pasagjerëve.

Punimet e kryera për zgjerimin e pjesës të terminalit do të kapin një vlerë prej rreth 20 milion Euro. Me anë të këtij investimi aeroporti synon të rrisë kapacitetin e tij në 1,5 milion pasagjerë në vit.

Do të hapen pika të tjera kontrolli, do të ngrihen konvejerë të tjerë bagazhesh, porta dalje dhe hyrje për pasagjerët si dhe zyra të tjera.

Terminalit ekzistues do t'i shtohet një sipërfaqe prej 3943 m<sup>2</sup>. Punimet për rritjen e kapacitetit të aeroportit do të përfundojnë në shtator 2009.

Në këtë aeroport operojnë 13 kompani ajrore Shqiptare dhe të huaja në rreth 32 destinacione, me rreth 190 fluturime në javë.

Nga Maji 2007-ës, nga pista e aeroportit ndërkombëtar "Nënë Tereza" ngrihet gjiganti gjerman i transportit ajror, Lufthansa, me dy fluturime në ditë drejt Muniht.

Gjatë vitit 2007, nga ky aeroport u realizuan rreth 18,000 fluturime, drejt Londrës, Vjenës, Romës, Milanos, Budapestit, Athinës, Barit, Stambollit, Lubjanës, Beogradit, Muniht dhe destinacioneve të tjera evropiane.

Për të udhëtuar për në aeroport dhe anasjelltas mund të merrni një taksì që kushton 15-20 €, ose mund të përdorni shërbimin e transportit me autobus me një tarifë prej 1,5 €.

Shërbimi i transporti për udhëtarët nga Tirana për në Rinas funksionon gjatë gjithë javës. Autobusët lëvizin nga Tirana në Rinas nga ora 07:00 -18:00 dhe nga Rinas në Tirana nga ora 07:00 -19:00, me një interval kohor prej një ore.

Shërbimi taxi i aeroportit mundësohet nga ATEX SHPK. Ky shërbim operon transfertat nga aeroporti drejt të gjitha qyteteve të Shqipërisë për grupe apo individë. Ky shërbim është profesional dhe personal, 24 orë në ditë, në shtatë ditë e javës. Tel.: 00355 68 20 49598 / 69 40 00030.

Rrugët automobilistike që lidhin Tiranën me qytetet e tjera të vendit janë në përmirësim të vazhdueshëm.

Tirana ndodhet rreth 250 km larg pikave të kalimit kufitar me Greqinë, Kakavijën dhe Kapshticën; 140 km larg nga Hani i Hotit, pikë kufitare me Malin e Zi; rreth 230 km nga Qafa e Morinës në kufi me Kosovën; dhe rreth 140 km nga Qafa e Thanës dhe Tushemishti në kufi me Maqedoninë.

Kompania amerikane Bechtel po punon për ndërtimin e rrugës Durrës-Kukës. Sot duhen rreth gjashtë orë të udhëtosh nga Tirana deri në Qafë të Morinës,

pikën kufitare me Kosovën. Kur të mbarojë rruga e re e gjithë kjo distancë do të mund të përshkohet në rreth dy orë.

## Qyteti i universiteteve

Ekonomia e metropolit të Tiranës përfiton shumë nga fakti se këtu është përqendruar numri më i madh dhe më cilësor i universiteteve dhe shkollave të tjera të vendit, të të gjitha niveleve dhe llojeve si dhe numri më i madh i instituteve kërkimore-shkencore.

Në Tiranë ka rreth 247 institucione arsimore, ndër të tjera 5 universitete shtetërore dhe 17 universitete private ku studiojnë rreth 51,700 studentë nga i gjithë vendi.

Universiteti i Tiranës është më i madhi, por edhe universitetet private ofrojnë kushte të mira dhe nivel të mirë mësimdhënie.

Tirana është qendra e universiteteve të tilla të huaja si New York University, ([www.unyt.edu.al](http://www.unyt.edu.al)) Kristal, Zoja e Këshillit të Mirë ([www.unizkm.edu.al](http://www.unizkm.edu.al)), Universiteti Europian i Tiranës ([www.universitetieuropean.com](http://www.universitetieuropean.com)), etj.

Përveç shkollave të sistemit arsimor të mesëm të përgjithshëm publik dhe jopublik në Tiranë funksionojnë edhe një seri shkollash të mesme teknike dhe profesionale si Harry Fultz, Hoteleri-Turizëm, Karl Gega, Flabina, Ekonomisti, Qendra e Formimit Profesional, shkolla e filmit "Marubi" etj. Institucione shkollore dhe shkencore të përmendura më lart janë vendosur në Tiranë për shkak se qyteti ofron infrastrukturën më të mirë arsimore në vend.

Shumica e tyre ofrojnë të gjitha mjetet e nevojshme për të plotësuar nevojat e një ekonomie në rritje për forca pune të kualifikuara dhe të orientuar drejt performancës.



## KU ËSHTË FOKUSUAR EKONOMIA E TIRANËS

### Qyteti ku janë investuar 50% të kapitaleve të huaja në Shqipëri

Në Tiranë ka një shtrirje të konsiderueshme të kompanive të huaja, të cilat kanë investuar kapitalet e tyre në Shqipëri dhe ndikojnë fuqishëm në rritjen ekonomike së saj.

Tirana u ofron investimeve të huaja qetësi dhe siguri si dhe një infrastrukturë në përmirësim të vazhdueshëm.

Deri në shtator 2008 bashkia e Tiranës ka investuar 876,444 mijë leke për qytetin.

Bashkia vazhdon të punojë intensivisht në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe arsimore.

Sipas Bankës së Shqipërisë në Tiranë janë vendosur 80% e sipërmarrjeve me kapital të huaj apo të përbashkët si dhe filiale, degë apo zyra përfaqësimi të shumë kompanive të njohura multinacionale.

Fluksi i investimeve të huaja direkte në Shqipëri gjatë vitit 2007, sipas Bankës së Shqipërisë, ishte 463 milion Euro.

Në Shqipëri gjatë vitit 2007, sipas INSTAT, numri i ndërmarrrjeve me kapital të përbashkët dhe të huaj ishte 1354, nga të cilat 569 operojnë në fushën e prodhimit dhe 785 në fushën e shërbimeve.

Duke iu referuar të dhënave zyrtare të Institutit të Statistikave vihet re se numërim më të madh të investimeve e përbëjnë ato greke dhe italiane.

Ndër këto investime përmendim konsorciumin Panafone (Gr) me Vodafone (UK) për operatorin e dytë GSM me kapital fillestar të investuar 38.1 milionë dollar, Hotel Rogner Europapark, i ndërtuar nga një shoqëri private ndërtimi austriake me kapital fillestar të investuar 12 milion dollarë, Coca-Cola Tirana s.r.l. , një joint venture me Busi Group Itali, me kapital fillestar të investuar 2,9 milionë dollarë. Coca-Cola.

Legjislacioni shqiptar është i hapur përse i përket vendosjes së shoqërive të huaja si dhe krijimit të shoqërive të përbashkëta.

Shoqëritë e huaja mund të vendosen sipas procedurave të ngjashme me ato që kërkohen për kompanitë shqiptare. Ligji shqiptar nuk bën asnjë diskriminim midis kompanive të huaja dhe atyre shqiptare.

Legjislacioni shqiptar për investimet e huaja është veçanërisht liberal dhe ofron garanci të konsiderueshme për të gjithë të huajt, qofshin këta persona fizikë apo juridikë, që dëshirojnë të zhvillojnë veprimtari ekonomike në Shqipëri.

Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje për promovimin dhe mbrojtjen e investimeve të huaja direkte me një sërë vendesh si Ukraina, Maqedonia, Sllovenia, SHBA, Turqia, Austria, Bulgaria, Danimarka, Egjipti, Gjermania, Rusia, Suedia, Anglia, Republika Çeke, Holanda, Malajzia, Romania, Kroacia, Polonia, Tunizia dhe Zvicra.

Investitorët e huaj mund të gjejnë në Tiranë të gjitha burimet e nevojshme për një investim të suksesshëm: infrastrukture rrugore, logjistike dhe institucionale, burime lëndë të parë afër, forca të kualifikuara pune si dhe ekspertizë të bazuar në përvojën evropiane.

Tabela 1 jep me përafërsi çmimet për qiratë e zyrave dhe magazinave.

Qiratë e zyrave	Çmimi €/m <sup>2</sup> /muaj
Qendra Biznesi	10 - 30
Apartament vetëm me zyra	6 - 12
Apartament me ndonjë zyrë	4 - 6
Qiratë e magazinave	
Brenda vijës së verdhë	3 - 5
Jashtë vijës së verdhë	2.5 - 4

Tabela 1: Qiratë e përafërta për zyra dhe magazine në Tiranë, për 2009-ën.

### Qyteti i një bumi të paparë të industrisë së ndërtimit

Tirana është qyteti që zë vendin kryesor në zhvillimin e sektorit të ndërtimit në Shqipëri.

Mbi 420 firma ndërtimi ose rreth 80% e gjithë firmave ndërtuese në vend janë të përqendruara në Tiranë, ku ritmi i ndërtimit është 10 herë më i lartë se në çdo qytet tjetër të Shqipërisë.

60 % të veprimtarisë ndërtimore e zë ngritja e ndërtesave të banimit. ([www.shnsh.org](http://www.shnsh.org))

Në Tiranë gjen shumë ndërtime moderne të gërshetuara me stilin vendas dhe të huaj. Janë disa studio të huaja që po japin ndihmesën e tyre për transformimin e qendrës së metropolit shqiptar.

Ka filluar implementimi i masterplanit francez i hartuar nga studioja franceze "Architecture Studio". Sipas tij në qendër të Tiranës do të lartësohen 10 kulla 85 metërshe.

Tre prej tyre janë projektuar tashmë respektivisht prej studios daneze "Henging Larsens Tegnestue", asaj belge "51N4E" dhe studios italiane "Archea Associate".



51N4E në prill 2008 fitoi edhe konkursin ndërkombëtar për rehabilitimin e sheshit "Skënderbe" në Tiranë.

Ky projekt ofron një ridimensionim të ri radikal të kësaj hapësire publike në qendrën më historike të qytetit. Punimet rehabilituese janë parashikuar të mbyllen në 2009.

Ndërsa Parku i Madh i Tiranës dhe Parku Qendror, të propozuar në studimin urbanistik të qendrës së Tiranës, janë studiuar nga Njësia e Planit Rregullues të Qytetit në bashkëpunim me Institutin Berlage të Rotterdamsit në Holandë.

Po ashtu në Tiranë gjenden edhe shumë kompani të tjera dhe institucione të specializuara vendase dhe të huaja si Mak Albania LTD, Gintas Alb etj, të cilat mund të shërbejnë si partnerë potencialë për industrinë e ndërtimit.

Grupi shqiptar i ndërtimit është organizuar në shoqata ([www.shnsh.org](http://www.shnsh.org)), po kështu edhe arkitektet dhe inxhinierët civil.

Tirana mund të etiketohet si qyteti i ngjyrave pasi shumica e ndërtimeve është konturuar me ngjyra të gjalla të cilat krijojnë kontraste.

Ngjyrimi i fasadave të Tiranës ishte një ide e kryebashkiakut Edi Rama. Ngjyrat gjallëruan qytetin, ku mbizotëronte grija e zymtë, dhe personifikuan më së miri erën e re të ndryshimeve në jetën e Tiranës.

Intonacioni i këtyre ngjyrave është goditës duke krijuar një lloj fizionomie arkitekturore ose individualizmi të ri të qytetit.


### Destinacion i përhershëm i të gjithë turistëve në Shqipëri

Tirana si kryeqytet, qytet me të vetmin aeroport ndërkombëtar dhe afër Durrësit, portit më të madh shqiptar në Adriatik, një prej qendrave bregdetare më të mëdha pushuese në vend, dhe si qendra kryesore ekonomike dhe social-kulturore e vendit, është një nga destinacionet e përhershëm të pothuajse të të gjithë vizitorëve të huaj dhe atyre vendas.

Gjatë vitit 2008, Shqipëria u vizitua nga rreth 1,245,000 shtetas të huaj. Shumica e vizitorëve ishin nga vendet evropiane.

Shumë njerëz lëvizin drejt Tiranës jo vetëm për arsye biznesi, por edhe për të vizituar kryeqendrën e Shqipërisë pasi këtu gjenden të gjitha institucionet kulturore dhe sportive të nivelit kombëtar.

Në nëntor të 2007-ës, Komiteti Përzgjedhës i Swiss Tourism Awards i akordoi qytetit të Tiranës çmimin "Kryeqytet me burime të shumta i projektuar me entuziazëm drejt së ardhmes, vend me prirje të mëdha drejt turizmit" në kategorinë "Destinacion për t'u zbuluar" për vitin 2007.



Tirana ka marrë tashmë pamjen e një qyteti të madh europian me arkitekturë mbresëlënëse, godina moderne, me dyqane të panumërta, kafe, bare dhe restorante, me një bulevard të gjerë me tetë korsi që ndërpritet në mes nga lumi i Lanës.

Turizmi në Tiranë ka pësuar një bum të vërtetë cilësor dhe sasior në vitet e fundit. Këtë e tregon më së miri hapja e një hoteli të ri me 5 yje të zinxhirit të njohur hotelier "Starwoods", si dhe dyfishimi i numrit të njërive akomoduese gjatë kësaj periudhe.

Në Tiranë ka 74 njësi akomoduese me një kapacitet prej 3,000 shtretër. Këtu ndodhen tre nga hotelet më të mëdha të vendit.

"Tirana International Hotel", një hotel katëryjesh me 154 dhoma, i administruar nga menaxherë shqiptarë, ndodhet në qendrën komerciale të Tiranës i rrethuar nga dyqane, bare dhe restorante. ([www.tirana-international.com](http://www.tirana-international.com))

"Sheraton Tirana Hotel & Towers" me 151 dhoma, hoteli i parë pesëyesh në Tiranë, ndodhet pranë kompleksit argëtues dhe tregtar në zemër të Tiranës; ([www.starwoodhotels.com](http://www.starwoodhotels.com)).



"Rogner Hotel Europapark" me 137 dhoma, i administruar nga rrjeti hotelier austriak Rogner, ofron kushte perëndimore jetese. Rogner Hotel Europapark është një vendtakimi për diplomatët, qeveritarë dhe biznesmenët vendas dhe të huaj ([www.hotel-europapark.com](http://www.hotel-europapark.com)).

Tabela 2, tregon me përafërsi çmimet e hoteleve në euro sipas kategorive:

Kategoria e hotelit	5 yje	4 yje	3 yje	Të tjera
Dhoma teke	235-275	120-180	70-120	20-30
Dhoma room	250-290	130-210	50-100	25-40

Tabela2: Çmimet e përafërta të hoteleve në Tiranë për 2009-ën.

### Qyteti i qendrave më të mëdha tregtare në vend

Tirana si qyteti më i madh i Shqipërisë zotëron fuqinë blerëse më të madhe në vend. Mumentalisht Tirana ka gjashtë qendra tregtare. Katër prej tyre përveç tregtisë përdoren edhe për qëllime të tjera dhe janë vendosur në qendër të qytetit (European Trade Center Galeria, Twin Towers, Torre Drini Shopping Center dhe Sheraton Shopping Plaza). Dy të tjerat janë më të mëdha dhe janë vendosur në pjesën perëndimore të qytetit.



QTU-ja, ([www.qtu-al.com](http://www.qtu-al.com)), qendra më e madhe tregtare në Shqipëri, është vendosur në autostradën Tiranë-Durrës, vetëm 6 km larg qendrës së qytetit.

Qendra Tregtare "UNIVERS" ka një sipërfaqe totale prej 65,000 m<sup>2</sup>, sipërfaqe të ndërtuar rreth 45,000m<sup>2</sup>, sipërfaqe dyqanesh 22,000m<sup>2</sup> dhe 1,000 vende parkimi.

Organizimi i dyqaneve, sistemi i kondicionimit dhe i ventilimit, pastërtia dhe siguria, veprimtaritë e ndryshme artistike, bar - restorantet e bëjnë qendrën një vend ku blerja kthehet në kënaqësi.

90% e të huajve që jetojnë në Tiranë janë vizitor të rregullt të kësaj qendre. Në vitin 2007, rreth 3 milion konsumatorë vizituan qendrën "Univers", 20% më shumë se në vitin 2006-të.

Qendra tregtare Casa Italia me një sipërfaqe të shfrytëzueshme prej 20,000 m<sup>2</sup> ndodhet në km 0 të autostradës Tiranë-Durrës. Në këtë qendër janë vendosur tashmë dyqane të tilla si Conad, Jysk, Oviessa, Upim dhe Trony.

City Park Tirana është një qendër tjetër tregtare, puna për ndërtimin e së cilës pritet që të përfundojë gjatë gjysmës së parë të viti 2009.

Ky projekt përbehet nga qendra tregtare me një sip. prej 39,000 m<sup>2</sup>, restorante, një dyqan për pajisje elektronike dhe një hipermarket ndërkombëtar.

City Park është pjesë e një qendre të madhe tregtare, e cila do të ketë edhe një park të madh ndërkombëtar lodrash për fëmijë si dhe një ekspozitë ku do të ofrohen 12 lloj makinash.

City Park ndodhet në autostradën Tiranë-Durrës, 12 km larg Tiranës, 25 km larg Durrësit dhe 5 km larg Aeroportit "Nënë Tereza" të Tiranës.

City Park është projekt i AM Group Development Company, ndërsa Colliers International Southeast Europe ([www.colliers.com](http://www.colliers.com)) është agjenti ekskluziv i dhënies me qira të këtyre ambienteve.

Në Tiranë ka dhe shumë qendra të tjera më të vogla tregtare, të cilat kryesisht janë të vendosura në qendër të qytetit si Conad, Bonus, European Trade Center, Smart Shopping, Torre Drin apo Sheraton Shopping Center.

Këto qendra tregtare ofrojnë produkte nga më të ndryshme si veshje, aksesori, bizhuteri, kozmetikë si dhe shërbime estetike, bar kafe, etj.

Ato ofrojnë ndër të tjera edhe produktet të markave nga më të njohurat si Nike, Lancôme, Samsonite, Levis, Diesel, Lee, Pupa, Luxotica, etj.

Rruga kryesore për veshje, këpucë, etj është rruga "Myslym Shyri", ku shumica e produkteve që tregtohen aty vijnë nga Italia dhe Greqia.

Dyqane të tjera luksi do të mund të gjeni edhe në zonën e Bllokut, një zonë me shumë bare dhe restorante, një nga më të preferuarat e rinisë së Tiranës.

Ndërsa disa nga emrat e njohur si Beneton, Sergio Tacchini ndodhen tek rruga e Durrësit.

Tirana ka edhe shumë tregje me shumicë që furnizojnë gjithë Shqipërinë me mallra. Filiale të kompanive më të mëdha të prodhimit të automobilave tregtojnë në Tiranë makina të tilla si Mercedes, Fiat, Volkswagen, Posrche, BMW, Ford etj.



### Qendër aktiviteteve

Në Tiranë zhvillohen pothuajse të gjitha aktivitetet ekonomike dhe social-kulturore ndërkombëtarë në Shqipëri.

Pjesa më e madhe e të gjitha panairëve të biznesit në nivel kombëtarë dhe ndërkombëtar, e aktiviteteve social-kulturore dhe sportive, që zhvillohen në Shqipëri, mbahen në Tiranë.

Qyteti ofron të gjithë infrastrukturën e nevojshme për këtë lloj aktiviteteve si dhe pozicionin e tij të favorshëm gjeografik sepse ndodhet në qendër të Shqipërisë.

Tirana është vendi ideal për organizimin e konferencës suaj. Ajo ofron kapacitetin prej 2,500 vendesh dhe 3,000 shtretëresh.

Pallati i Kongreseve është struktura më e madhe në Tiranë dhe në Shqipëri, dhe ndodhet në zemër të Tiranës fare pranë tre hoteleve më të mëdha të qytetit, institucioneve qeveritare, kulturore dhe tregtare, stadiumit, parkut dhe Bllokut, kështu ju mund të arrini lehtë në vendet tuaja të interesit.

Qyteti i Tiranës ofron një numër të madh salla konferencash të përmasave të ndryshme me kapacitet nga 10-400 persona. Shërbimet e shumta të ofruara e kanë pozicionuar qytetin e Tiranës në qendër kryesore të konferencave në Shqipëri.



Në qytetin e Tiranës ushtrojnë aktivitetin e tyre disa shoqëri të organizimit të panairove, të cilat me mbështetjen edhe të Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë organizojnë panairove vjetore biznesi kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ndër to mund të përmendim Expo Prima ([www.expo-prima.com.al](http://www.expo-prima.com.al)), Fiera del Levante, Klik Group ([www.klikekspogroup.com](http://www.klikekspogroup.com)), dhe Elida Co 94.



Në 2008 në Tiranë u zhvilluan disa panairove, në të cilët kompani shqiptare dhe të huaja ekspozuan prodhimet, makineritë dhe teknologjitë e tyre moderne.

Në Panairin e Përvitshëm Ndërkombëtar të organizuar nga Klik Expo Group në nëntor 2008 morën pjesë kompani të njohura vendase dhe të huaja si Vodafon, Albania Mobile Communication, Kurum International, Alumil, Lagan Group, Gorenje, Banka Intesa San Paolo, AM Group Deka & Olim, EHW, Autoriteti Portual i Barit, Gruppo Becchetti, British American Tobacco, AGNA Group, Edison, Eridania, Enel - korporata energjitike e Italisë, Dei - korporata energjitike e Greqisë, Raiffeisen Bank, Bambi, Pionier, etj.

Tirana me stadiumin kombëtar të futbollit "Qemal Stafa", pallatin e sporteve "Asllan Rusi" si dhe ambiente të tjera sportive të standardeve evropiane ofron kushte shumë të mira për zhvillimin e aktiviteteve sportive ndërkombëtare.

Pallati i Kongreseve, Qendra Ndërkombëtare e Kulturës si dhe Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit, kinema Millenium me një infrastrukturë bashkëkohore mirëpresin çdo vit aktivitet kulturorë me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare. Tirana po bëhet çdo ditë e më shumë një pikë takimi për koncerte dhe ngjarje të tjera të rëndësishme.

Në qershor dhe korrik 2008 në Tiranë dhanë shfaqje këngëtarë dhe grupe të tilla të njohura si James Blunt dhe grupet e rokut Whitesnake and Def Leppard.

Në 2007, në Tiranë janë zhvilluar koncerte të shumta nga grupe dhe artistë me famë botërore si Europe dhe Deep Purple, dy grupe të muzikës rok. Gjithashtu kanë ardhur në Tiranë Sean Paul, Zucchero, Schiller dhe ish-solistja e grupit Cranberries, Dolores O'Riordan si dhe grupi latino-amerikan Vaya con Diaz.

Një aktivitet tjetër shumë i rëndësishëm në botën e spektaklit ishte edhe organizimi për të katërtin vit radhazi i aktivitetit "Miss Globe International".

Në Tiranë ndodhet edhe Muzeumi Historik Kombëtar, Muzeu Arkeologjik, Muzeu Mezuraj, ([www.mezuraj.muzeum](http://www.mezuraj.muzeum)) i pari muze privat arti në Shqipëri, Galeria Kombëtare e Arteve, Biblioteka Kombëtare si dhe shumë muzeume dhe institucione të tjera të kulturës, historisë dhe artit kombëtar që tërheqin çdo vit një numër të madh vizitorësh vendas dhe të huaj.

Në 2007, në Tiranë u hapën tre salla kinemaje të reja me një kapacitet total prej 630 vendesh.

Dy prej tyre ndodhen pranë ambienteve të hotel Sheraton dhe kanë përkatësisht 30 dhe 100 vende.

Ndërsa salla e tretë është një kinema verore, ndodhet tek amfiteatri i Akademisë së Arteve dhe ka një kapacitet prej 500 vendesh. ([www.empire-al.com](http://www.empire-al.com))

## HAPJA E NJË BIZNESI TË RI NË TIRANË

### Rregullat e emigrimit dhe qëndrimit për të huajt

Nga data 01.12.2008 në Shqipëri ka hyrë në fuqi një ligj i ri për të huajt duke zëvendësuar ligjin Nr. 8492, dat. 27.5.1999. Ligji i ri për të huajt Nr. 9959, dat. 17.7.2008, garanton tipe të reja vizash, leje qëndrimi dhe pune.

Për të hyrë në Republikën e Shqipërisë të huajt duhet të disponojnë një pasaportë ose dokument tjetër të vlefshëm udhëtimi që mundëson vërtetimin e identitetit të shtetësisë së personit, i cili të jetë i vlefshëm deri 3 muaj pas hyrjes në Republikën e Shqipërisë dhe të njihet nga autoritetet shqiptare; kartë identiteti për qytetarët e atyre vendeve, të cilëve u lejohet hyrja me këtë dokument ose leje-kalimi të OKB-së e filialeve të saj, Këshillit të Evropës, Bashkimit Evropian, NATO-s dhe organizmave të tjerë të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatimin e këtij ligji.

Të huajve mund t'u kërkohet të disponojnë edhe dokumentet e nevojshme në bazë të të cilave është lëshuar viza ose që mbështesin motivin e hyrjes në Republikën e Shqipërisë, ose të vërtetojnë se disponojnë mjete të mjaftueshme jetese, në bazë të të cilave krijojnë besueshmëri dhe provojnë se nuk do t'u drejtohen fondeve publike për të siguruar jetesën në Shqipëri. Si provë e tillë do të shërbejnë; biletë kthimi, rezervim hoteli, korrespondencë biznesi, kartë krediti etj.

Shtetasi e huaj kanë të drejtë të kërkojnë leje qëndrimi pranë autoriteteve kompetente në Ministrinë e Brendshme, e cila i pajis me leje qëndrimi, të huajt që kanë kushte e mjete të përshtatshme jetese, janë në gjendje të argumentojnë motivin e

qëndrimit, përshtatshmërinë e tyre për të kryer veprimtarinë e parashikuar, janë në gjendje të argumentojnë angazhimin e tyre të plotë, si dhe nevojën për këtë angazhim në veprimtarinë për të cilën kërkojnë lejen e qëndrimit.

Në bazë të ligjit të huajve për veprimtari të pavarur ekonomike, si investitor, i jepet leja e punës tip B/I me një afat kohor 3 vjeçar kur ai zotëron 10 % të kapitalit në një ndërmarrje si dhe kur ai bën një investim që është të paktën në vlerën 100 mijë Euro.

Lejet e punës lëshohen nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale.

### Hapja e një biznesi

Më 14 prill 2008 Parlamenti shqiptar aprovoi ligjin e ri Nr 9901 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë një kuadër ligjor bashkëkohor të thjeshtë, të qartë dhe të përditësuar për shoqëritë tregtare.

Ligji merr në konsideratë elemente të vlefshme nga Ligji ekzistues Nr. 7638 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe ligji nr. 7632 "Për pjesën e përgjithshme të Kodit Tregtar" për të ruajtur sa më shumë praktikën ligjore shqiptare, e cila është zhvilluar gjatë 15 vjetëve të fundit. Gjithashtu, ligji i ri nuk bën ndryshime thelbësore në mënyrën e gjykimit të konflikteve dhe padive nga gjykatat për çështjet që lidhen me shoqëritë tregtare sipas ligjit të mëparshëm nr 7638 "Për shoqëritë tregtare".

Ligji i ri është harmonizuar edhe me legjislacionin e brendshëm, veçanërisht me Kodin Civil, Ligjin për QKR-në, dhe të gjitha ligjet e tjera të veçanta të biznesit, e në mënyrë të veçantë me ligjin "Për letrat me vlerë". Për tu njohur me këtë ligj mund të vizitoni linkun e mëposhtëm: ([www.mete.gov.al/mat.php?idm=608&l=a](http://www.mete.gov.al/mat.php?idm=608&l=a))

Gjithashtu sipas ligjit nr 9920 dt 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 104, autoritete fiskale janë të autorizuara të kërkojnë fillimin e procedurave të falimentimit, kur kompania deklaron humbje të kapitaleve të saj për tre vite me radhë.

Në bazë të Ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", nga data 1 Shtator 2007 ka filluar të funksionojë Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Biznesit.

Ky ligj rregullon organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e kësaj qendre, administrimin e regjistrit tregtar, përcaktohen subjektet që regjistrohen dhe procedurat e regjistrimit.

Duke vizituar Qendrën e re Kombëtare të Regjistrimit (QKR) ju mund të regjistroni biznesin tuaj shpejt, thjesht dhe me më pak shpenzime.

Në momentin e fillimit të një veprimtarie tregtare, çdo person fizik apo juridik, vendas a i huaj, duhet së pari të regjistrohet në QKR ose pranë sporteleve të vendosura në Bashki. Regjistrimi në QKR është kusht i domosdoshëm për marrjen e licencës.

QKR është e vendosur në Rr. "Lek Dukagjini" Nr 5. Orari i hapjes së QKR është: Hënë - Enjte 08:30 -14:00 dhe të Premten 08:30 - 11:30  
Tel.: +355 42 250 066

E- mail: [info@qkr.gov.al](mailto:info@qkr.gov.al), për më shumë informacion ju mund të klikoni në faqen zyrtare të internetit: ([www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)).

QKR ofron një zgjidhje "one-stop-shop" për regjistrimin e biznesit. QKR shërben si sportel i vetëm për të gjitha llojet e entiteteve të biznesit në mbarë Shqipërinë, për të kryer dhe aplikuar për të gjitha proceset e regjistrimit të biznesit.

QKR dhe procedurat elektronike të saj bëjnë që Regjistri Tregtar Shqiptar dhe regjistrimi i biznesit të përputhen plotësisht me të gjitha direktivat e zbatueshme të Bashkimit Europian dhe e bën regjistrimin e biznesit dhe informacionin e Regjistrimit Tregtar plotësisht të aksesueshëm për përdoruesit shqiptarë, si edhe për përdoruesit e huaj të biznesit.

Procedurat e regjistrimit në QKR thjeshtojnë dhe reduktojnë dukshëm koston e shërbimeve për regjistrimin e biznesit, duke reduktuar në një ditë të vetme periudhën e nevojshme për të regjistruar një biznes të ri dhe për të bërë ndryshime në informacionin për kompaninë e regjistruar.

Licenat që kërkohen për aktivitetet specifike do të merren në vijim pasi të jetë kryer regjistrimi pranë QKR-së.

### Hapi I:

Aplikimi për regjistrimin fillestar mund të bëhet në sportelet e QKR-së në Tiranë ose në sportelet e shërbimit, të vendosura në bashki.

Çdo shërbim që ofron kjo qendër kryhet kundrejt një tarife prej 100 lekë.

### Për regjistrimin fillestar duhet:

Për të filluar një regjistrim, një aplikanti i duhet të plotësojë formularin e aplikimit. Formulari i aplikimit është specifik për lloje të ndryshme entitetesh që aplikojnë (persona fizikë që bëjnë biznes apo kompani).

Pasi formulari i aplikimit plotësohet, aplikanti paraqet formularin e aplikimit personalisht, në çdo sportel shërbimi të QKR-së ose pranë sporteleve të Bashkisë, së bashku me dokumentat e tjera shoqëruese, të duhura.

### Lista e dokumenteve shoqëruese:

1. Dokument origjinal identifikimi (çertifikatë me fotografi, pasaportë, letërnjoftim), kopje e të cilit mbahet nga nënpunësi i sportelit.

2. Përsa i përket dokumentave të tjera shoqëruese theksojmë se kjo listë është specifike për formën të ndryshme ligjore biznesesh.

Pasi është identifikuar lloji i biznesit që do të regjistrohet, aplikanti mund të gjejë listën e dokumenteve shoqëruese, të bashkëngjitur në formën specifike të aplikimit për regjistrim, e cila mund të

merret ose në sportelet e QKR-së ose në faqen zyrtare të internetit të QKR-së ([www.qkr.gov.al/nrc](http://www.qkr.gov.al/nrc)).

### Në rast pranimit të regjistrimit.

Pas lëshimit të konfirmimit për aplikim, aplikimi dhe dokumentet shoqëruese shqyrtohen për vendimmarrje nga nëpunësi i autorizuar i QKR-së (regjistruesi). Nëse pas verifikimeve, nëpunësi i autorizuar (regjistruesi) konstaton se aplikimi është në përputhje me kërkesat e ligjit, brenda afatit maksimal prej 1 (një) ditë nga paraqitja e aplikimit ai miraton:

1. Kryerjen e regjistrimit;
2. Lëshimin e Numrit Unik të Identifikimit (NUIS), gjithashtu i njohur si NIPT;
3. Vërtetimin e kryerjes së regjistrimit dhe lëshimin e çertifikatave të regjistrimit (në rast kur biznesi regjistrohet).

Këto çertifikata (një për çdo vend ku biznesi kryen aktivitet) mund të merren nga aplikanti (ose personi i autorizuar) në çdo sportel shërbimi të QKR-së;

4. Kryerjen e publikimit elektronik të regjistrimit në Buletin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit të QKR-së, e cila mund të shihet në faqen zyrtare të internetit të QKR-së ditën pas miratimit të regjistrimit.

Plotësimi i regjistrimit dhe lëshimi i çertifikatës së regjistrimit, janë evidenca e aplikantit për regjistrimin e biznesit, për regjistrimin fiskal të biznesit (tatim taksa), për regjistrimin në sigurimet shoqërore, për regjistrimin në sigurimet shëndetësore si dhe regjistrimin me autoritetet e Inspektoriatit të Punës.

### Hapi 2

Pasi subjekti merr certifikaten e rregjistrimit atehere vazhdon procedurën për marrjen e lejeve specifike pranë institucioneve përkatëse si dhe bën pagesën e detyrimeve, për biznesin e vogël pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe për biznesin e madh pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. ([www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al))

### Ndihma që ofrohet për këtë qëllim

Për krijimin e një shoqërie tregtare sipas legjislacionit shqiptar mund të merret asistencë juridike pranë Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë ([www.cci.gov.al](http://www.cci.gov.al)); Zyrratë të Tatim-Taksave me adresë interneti: ([www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al)) ose pranë zyrratë avokatore:

Kalo & Associates ([www.kalo-attorneys.com](http://www.kalo-attorneys.com));

Boga & Associates ([www.bogalaw.com](http://www.bogalaw.com));  
Tonucci & Partners ([www.tonucci.it](http://www.tonucci.it)).

Kalo & Co publikon çdo tre muaj një buletin informativ ligjor i cili ofron komente dhe informacione për problemet ligjore mbi biznesin në Shqipëri.

Gjithashtu ky buletin mund të gjendet edhe në web sitin e kompanisë. Në Tiranë veprojnë 4 studio ndërkombëtare auditimi:

1. Kpmg ([www.kmpg.al](http://www.kmpg.al));
2. Price Waterhouse Coopers ([www.pwc.com](http://www.pwc.com));
3. Deloitte & Touche ([www.deloitte.com.al](http://www.deloitte.com.al));
4. Ernst & Young ([www.ey.com](http://www.ey.com)).

(Një listë më të detajuar të studiove ligjore dhe të auditit në Tiranë mund ta gjeni: [www.hg.org/lawfirms/Albania/Tirana.html](http://www.hg.org/lawfirms/Albania/Tirana.html)).

Drejtoria e Promovimit të Qytetit ([contacted@tirana.gov.al](mailto:contacted@tirana.gov.al)) dhe Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve (Alb-Invest) ([www.albinvest.gov.al](http://www.albinvest.gov.al)) të cilat japin asistencë për lehtësimin e investimeve të huaja dhe sigurojnë shërbime mbështetëse për ta.

### Sistemi bankar

Sistemi bankar në Republikën e Shqipërisë ka pësuar vitet e fundit rritje, e cila lidhet me konsolidimin e stabilitetit politik të Shqipërisë.

Kjo ka sjellë shtimin e numrit të bankave dhe gamën e shërbimeve që ato ofrojnë. Monedha e përdorur është Leku.

Kartat e debitit dhe kreditit po përdoren masivisht në Shqipëri. Nga bankat e nivelit të dytë mund të pajiseni me karta Visa apo MasterCard.

Nga qershori i 2008-s Banka Alpha në Tiranë dhe degët e saj në qytete të tjera ofrojnë shërbimin e kartave American Express® dhe American Express Gold.

Në Tiranë operojnë 17 banka: si Raiffeisen, Intesa Sanpaolo Bank Albania, NGB Bank, ProCredit, Banka Italiane e Zhvillimit etj.

Në muajin qershor 2007, Banka Amerikane e Shqipërisë dhe Banka Italo Shqiptare u bënë pjesë e grupit të fuqishëm bankar Sannpaolo Imi



### Sigurimi shëndetësor

Sigurimi Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë është institucionalizuar në bazë të Ligjit "Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë" Nr. 7870, datë 13.10.1994.

Ai është kryesisht publik. Punëdhënësi detyrohet të derdhë çdo muaj, në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, kontributet e sigurimeve

Duke filluar nga 1 korriku 2008 kontributet paguhen në masën 21.7% nga punëdhënësi dhe 11.2% i mbahen punëmarrësit nga paga mujore.

Ndërsa kontributi për sigurimin shëndetësorë në një masë prej 3.4% ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit. Secili paguan 1.7%.

### Sa kushton blerja e pronave

Të huajt kanë të drejtë të blejnë pasuri private dhe tokë jobujqësore për të zhvilluar aktivitet ekonomik, kurse toka shtetërore jobujqësore mund t'iu shitet vetëm atëherë kur investimi i planifikuar është 1.5 herë më i madh se çmimi i tokës.

Të huajt nuk kanë të drejtë të blejnë tokë bujqësore, por kanë të drejtë ta marrin atë me qira për 99 vjet.

Personat fizikë dhe juridik privat shqiptarë kanë të drejtë të blejnë e të shesin lirisht troje ndërmjet tyre pa asnjë kufizim.

Çmimi i tokës është i larmishëm, ky çmim varet nëse toka ka apo jo kontakt me rrugën, është zonë industriale apo jo etj.

Tabela 3 pasqyron çmimet e tokës pranë qendrës së qytetit, në periferi të tij dhe në komunat fqinje.

Çmimi i parcelave të tokës për ndërtim banese dhe zyra në qendër të qytetit varion nga 1200 deri në 2000 euro/m<sup>2</sup> dhe në periferi të Tiranës nga 500 deri në 1000 euro/m<sup>2</sup>.

Segmenti i autostradës që lidh Tiranën me qytetin e Vorës, i cili ndodhet në mes të rrugës për në Durrës, preferohet shumë për pozicionimin e bizneseve te reja.

Çmimi i tokës në këtë hapësirë varion nga 120-200 euro/m<sup>2</sup>, ndërsa çmimi i tokës brenda kufijve të Vorës varion nga 100-200 euro/m<sup>2</sup>.

Çmimi i tokës private në komunat fqinje të Tiranës si, Selita, Dajt, Yzberishti dhe Farka varion nga 80-250 euro/m<sup>2</sup>.

Çmimi i Tokës	Çmimi €/m <sup>2</sup>
Në qendër të qytetit	1200 - 2000
Në periferi	500 - 1000
<b>Komunat fqinje</b>	
Në autostradë	120 - 200
Në Vorë	100 - 200
<b>Rajoni i Tiranës</b>	
Selitë, Dajt	150 - 250
Yzberisht	80 - 220
Farkë	150 - 250

Tabela 3 : Çmimet e përafërta të tokës në rajonin e Tiranës, për 2009-ën

### Taksat

Taksat dhe tatimet janë detyrime për t'u shlyer nga çdo person fizik a juridik që ushtron veprimtari fitimprurëse në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sistemi i taksave në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga taksa kombëtare dhe taksa e tarifave vendore. Taksa kombëtare mbi fitimin është 20% ndërsa tatimi i thjeshtuar mbi fitimin është 1.5% e xhiros.

Tatimi mbi të ardhurat personale llogaritet siç tregohet edhe në tabelën 4/a mbi të ardhurat e individëve dhe përcaktohet nga ligji Nr. 8438 "Për tatimin mbi të ardhurat", ndryshuar me ligjin Nr.9766, datë 09.07.2007.

E ardhura e tatueshme (në muaj)		Përqindje
Mbi (lekë)	Deri në (lekë)	
0	10.000	0 %
10.001 +	30.000	10 % e shumës mbi 10.000 lekë
30.001 +	Më tepër	10 % e shumës mbi 0 lekë

Tabela 4/a: Tatimet mbi të ardhurat personale në Shqipëri

Niveli dhe kategorizimi i taksave dhe tarifave vendore për Tiranën përcaktohen në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 3, datë 25.02.2008.

Detyrimi për taksën mbi pasurinë e paluajtshme është vjetor dhe ndahet në dy këste të barabarta.

Kësti i parë për kategorinë "Ndërtesa banimi" paguhet brenda datës 30 prill dhe kësti i dytë brenda datës 30 shtator. Për kategorinë "Ndërtesa të tjera" kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill dhe kësti i dytë brenda datës 30 qershor.

Taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor dhe ndahet në dy këste të barabarta ku kësti i parë paguhet brenda datës 31 mars të vitit dhe kësti i dytë brenda datës 30 shtator të vitit.

Toka bujqësore është klasifikuar në 10 kategori për të lehtësuar në këtë mënyrë përcaktimin e nivelit të taksës.

Qyteti i Tiranës për efekt të mbledhjes së taksës për zënie e hapësirave publike është ndarë në tre zona: A,B, dhe C.

Zona A përfshin qendrën e Tiranës; sipërfaqen brenda unazës së vjetër dhe dy rrugët kryesore të Tiranës: Rrugën e Durrësit dhe Rrugën e Kavajës.

Zona B përfshin sipërfaqen midis unazës së vjetër dhe asaj të re, ndërsa Zona C shtrihet në hapësirën midis unazës së re dhe vijës së verdhë.

Automjetet si tregohen në tabelën 4/b duhet të paguajnë tarifën për mirëmbajtjen e rrugëve qytetase kur hyjnë në qytet.

Taksa e tabelës, gjelbërimit dhe pastrimit paguhen një herë në vit deri në 20 Prill.

Siç është përcaktuar edhe në ligjin Nr. 9632, datë 02.02.2007 biznesi i vogël duhet të paguajë detyrimet e tij fiskale për regjistrim pranë organeve të pushtetit vendor.

Në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 9637, datë 31.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të gjithë taksapaguesit në nivel vendor mund të apelojnë kundër vendimit apo veprimit të zyrës së Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Kryetarit të Bashkisë brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit të detyrimit tatimor.

Si biznes i vogël janë klasifikuar ato biznese qarkullimi vjetor i të cilëve shkon deri në 8 milion lekë.

Sipërmarrjet me një qarkullim vjetor deri në 150 milion lekë klasifikohen si biznese të mëdha ndërsa sipërmarrjet me qarkullim vjetor mbi 150 milion lekë klasifikohen si biznese VIP.

Sipas ligjit taksa e biznesit të vogël llogaritet si detyrim vjetor dhe paguhet në 4 këste të barabarta.

Kësti i parë mund të paguhet brenda datës 20 prill, kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë deri më 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal.

Tabela 4/b tregon në mënyrë të detajuar taksat dhe tarifave vendore.

### Kualifikimi i fuqisë punëtore

Fuqia punëtore në Tiranë në përgjithësi është shumë e kualifikuar. Në Tiranë janë përqendruar pothuajse të gjitha institucionet trajnuese duke ofruar mundësira të panumërta për specializim dhe kualifikim.

Në Tiranë zhvillojnë aktivitetin e tyre 70 institucione që ofrojnë kurse kualifikimi në kompjuter, bankë, financë, kontabilitet, menaxhim biznesi, turizëm, ndërtim, hidraulikë, mekanikë, industri ushqimore, shërbime etj.

Ndër to mund të përmendim Institutin e Trajnimit dhe Menaxhimit të Ndërmarrjeve, Arsimimi i të Rriturve në Shqipëri (PARSh), Qendra Profesionale Don Bosco dhe Wisdom Center ([www.wisdomedu.info](http://www.wisdomedu.info)).



## Taksat dhe Tarifat Vendore

1 Taksa vendore mbi biznesin e vogël				
1.1 Niveli tregues i taksës (000/Lek)				
Qarkullimi vjetor (000/Lek)	Deri 2000	2001 3000	3001 4000	4001 5000
1 Shitje me pakicë	45	68	83	98
2 Shitje me shumicë	45	68	83	98
3 Prodhim	23.1	38.5	49	59.5
4 Shërbime	25	48	63	78
5 Profesione të lira	38	60	75	90
6 Ambulantë	8			
Qarkullimi vjetor (000/Lek)	5001 6000	6001 7000	7001 8000	
1 Shitje me pakicë	113	128	143	
2 Shitje me shumicë	113	128	143	
3 Prodhim	70	80.5	91	
4 Shërbime	93	108	123	
5 Profesione të lira	105	120	135	
6 Vendor				
2 Taksa mbi pasurinë e pa luajtshme				
2.1 Taksa mbi Ndërtesën				
Kategoritë	Lek/m <sup>2</sup> /vit			
1 Ndërtesa banimi				
- ndërtesa ndërtuar para 1993	10.5			
- ndërtesa ndërtuar pas 1993	21			
2 Ndërtesa të tjera				
- për tregti dhe shërbime të tjera	140 - 200			
	50			
2.2 Taksa mbi tokën bujqësore				
Kategoritë	Lek/ha/vit			
1	4000			
2	3500			
3	3000			
4	2600			
5	2100			
6	1700			
7-10	1300			
3 Taksa e fjetjes në hotel				
Taksa e hotelit është 5% e çmimit të dhomës / natë				
4 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja				
Kategoritë	% Ndikimit			
Zone A	2 - 4			
Zone B	2 - 3.5			
Zone C	2 - 2.5			
5 Taksa për zënien e hapësirave publike				
Kategoritë	Lek/m <sup>2</sup> /muaj			
Zone A	150			
Zone B	130 - 150			
Zone C	120 - 150			
6 Taksa e tabelës				
Kategoritë	Lek / vit			
Tabelë për qëllime identifikimi	1.500			
Tabelë e shprehur në shqip	3.000			
Tabelë e shprehur në gjuhë të huaj	3.000			
Tabelë për qëllime reklamimi				
Kategoritë	Lek/m <sup>2</sup> /vit			
Të zakonshme dhe të përbëra Elektronike	10.000			
	15.000			

Tabelë në funksion të ekspozimeve të hapura (panaie, spektakle)		Lek/m <sup>2</sup> /ditë
Tabela, Banderola	1.000	
7 Taksa e përkohshme e gjelbërt		
Kategoritë	Lek/vit	
Biznesi i vogël	2.500 - 50.000	
Biznesi i madh	7.000 - 200.000	
Biznesi vip	10.000 - 250.000	
8 Tarifa e regjistrimit		
Personat fizikë ambulantë	2.000	
Personat fizikë, vendas të huaj	7.000	
Personat juridik	12.000	
9 Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave		
Kategoritë	Lek/vit	
Shitje me pakicë		
Biznesi i Vogël	6.000 - 23.000	
Biznesi i Madh	7.000 - 30.000	
Biznesi Vip	14.000 - 40.000	
Shitje me shumicë		
Biznesi i Vogël	23.000	
Biznesi i Madh	25.000	
Biznesi Vip	35.000	
Njësi prodhimi		
Biznesi i Vogël	20.000 - 25.000	
Biznesi i Madh	70.000 - 75.000	
Biznesi Vip	150.000 - 160.000	
Subjekte ndërtimi		
Biznesi i Vogël	7.000 - 34.000	
Biznesi i Madh	10.000 - 115.000	
Biznesi Vip	20.000 - 180.000	
Njësi shërbimi		
Biznesi i Vogël	5.000 - 10.000	
Biznesi i Madh	7.000 - 20.000	
Biznesi Vip	15.000 - 30.000	
Profesione të lira		
Biznesi i Vogël	8.000 - 9.000	
Biznesi i Madh	10.000 - 20.000	
Biznesi Vip	20.000 - 30.000	
Ambulant	1.500	
Transport	5.000 - 17.000	
10 Tarifa e parkimit të automjeteve		
Kategoritë	Lek / ora	
Autobuza	100	
Mikrobuza	20 - 30	
Kamionët	10 - 50	
Taksi 4+1	20	
Autovetura		
Zona A	100	
Zona B	40	
Zona C	20	
11 Tarifë për mirëmbajtjen e rrugëve qytetase		
Kategoritë	100 Lek	
Automjete për transport të përzier		
Autobusë (jo qytetas)		
Kamionë		
Automjete për transport të veçantë		
Autotrena		
Gjysëm rimorkator		
Autokampe		
Makina ngarkimi, transporti		

Tabela 4/b: Taksat dhe tarifat vendore

## Sigurimi i fuqisë punëtore

Fuqinë punëtore mund ta siguronin nga Zyra Rajonale e Punësimit me adresë: Rr. Vllazën Huta, tel.: +355 42 377 848.

Kjo zyrë ofron informacion për tregun e punës. Nga kjo zyrë mund të siguronin kërkesat e personave për punë dhe profesionet e tyre.

Gjithashtu kompanitë mund ta sigurojnë staf të kualifikuar edhe nga Qendra Shqiptare për Shërbime Menaxheriale (ACMS) ([www.cmsalbania.com](http://www.cmsalbania.com)).

Kërkesat dhe ofertat e tregut të punës mund të gjenden edhe në gazetën Çelësi, në të përditshmen Gazeta Shqiptare, si dhe online në adresat e internetit:

[www.shekulli.com.al/punesime](http://www.shekulli.com.al/punesime)  
[www.njoftime.com](http://www.njoftime.com)  
[www.unepunoj.com](http://www.unepunoj.com)

## Marrja e njerëzve në punë dhe pagat

Marrëdhëniet e punës në Shqipëri rregullohen me anë të kontratave të punës duke pasur si bazë ligjore Kodin e Punës.

Kohëzgjatja normale javore e punës është maksimumi 48 orë në javë. Puna e kryer ditën e diel ose në ditët e festave zyrtare kompensohet me një shtesë page jo më pak se 25 % ose me një pushim të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer.

Ligji për Sigurimet Shoqërore rregullon marrëdhëniet në fushën e sigurimit shoqëror.

Punëdhënësi bën sigurimin e punëmarrësve duke filluar nga dita e fillimit të punës në bazë të kontratave të punës të përcaktuara dhe vazhdon sigurimin e punëmarrësve gjatë gjithë kohës që ky i fundit është në marrëdhënie pune.

Grevat janë shumë të pakta në Tiranë, dhe pothuajse nuk ekzistojnë fare në kompanitë e huaja. Megjithatë e drejta për grevë është e rregulluar me dekretin Nr. 7458, datë 22.1.1991, ndryshuar me ligjin Nr. 7636, datë 12.1.1992 i cili bën kufizime për kategori të veçanta të punësuarish për t'i siguruar shoqërisë shërbimet e domosdoshme.

Paga mesatare mujore për punonjësit në sektorin privat në pozicionet drejtuese të veprimtarive të ndryshme ekonomike është 47.700 Lekë ose (380€).

Ndërsa paga minimale mujore e lejuar për punëmarrësit për të gjithë degët e veprimtarive ekonomike është 17 mijë Lekë ose (140 €) dhe duhet të duhet të paguhet për 174 orë pune në muaj.

Pagat në Shqipëri janë ende të ulëta në krahasim me Evropën perëndimore. Kjo është një nga përparësitë më kryesore konkurruese që Shqipëria u ofron investitorëve të huaj.

## Importimi dhe eksportimi i mallrave

Procedurat e çdoganimit të importeve janë shumë të rëndësishme veçanërisht për kompanitë kur prodhimi i tyre varet nga lënda e parë e importuar.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit (MSA) në 2006 një nga ndryshimet e ndodhura në procedurën e zhdoganimit është reduktimi ose bërja zero e taksave për një pjesë të mallrave bujqësore dhe industriale, si dhe automjetet me origjinë nga BE, kusht për të cilën është paraqitja e Certifikatës EURO 1 (që vërteton origjinën e mallit).

Afati mesatar kohor i zhdoganimit është 10 ditë për mallrat e ardhura në rrugë detare dhe 5 ditë për mallrat e tjera. Afati mesatar i përpunimit të një praktike doganore është 1-2 orë ndërsa për 20% të tyre që i nënshtrohen kontrollit fizik ky afat zgjatet në 3-6 orë. Aktiviteti i import-eksportit në Shqipëri rregullohet nëpërmjet legjislacionit doganor i bazuar në ligjin Nr. 8449, datë 27.01.1998, "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë" ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 111, datë 05.03.1999, ndryshuar me ligjin Nr. 8473, datë 14.04.1999, ndryshuar me ligjin Nr. 8719, datë 19.12.2000, ndryshuar me ligjin Nr. 8999, datë 30.01.2003.

Drejtoria Rajonale e Doganës Tiranë përbëhet nga tre degë doganore: Dega Doganore Tiranë që ndodhet në qytetin e Tiranës, Dega Doganore Rinas (në aeroportin e Rinasit) dhe Dega Doganore Durrës (në portin e Durrësit).

Orari i hapjes së zyrave doganore Tiranë është: 08:00 -15:00 për ditët nga e hëna deri në të premten dhe 08:00 -13:00 për ditën e shtunë. Punohet edhe ditët e festave zyrtare. Vetëm dita e diel është pushim. ([www.dogana.gov.al](http://www.dogana.gov.al)).

## Dokumentacioni i nevojshëm për Importet në Shqipëri:

- Fatura
- Siguracioni i mallit dhe mjetit transportues (C.M.R)
- Certifikata e origjinës së mallit
- Certifikata e cilësisë së mallit
- Certifikata Euro 1 (plotësohet nga shitësi)
- Për mallra specifike leja përkatëse e Institucionit, p.sh: Për kafshë nga Ministria e Bujqësisë, për Medikamente nga Ministria e Shëndetësisë
- Kopje e deklaratës eksportuese të Shtetit shitës.(Triar)

## Dokumentacioni i nevojshëm për Eksportet në Shqipëri:

- Fatura
- Siguracioni i mallit dhe mjetit të transportit (C.M.R)
- Certifikatë origjinë
- Certifikatë cilësie
- Certifikatë Euro 1
- Kopje e deklaratës doganore të eksportit

Në Tiranë veprojnë disa agjenci specicioni që ofrojnë: transport për ngarkesa të çdo lloji dhe transport special, shërbim me kontenier, transport ngarkesash komplete, transport grupazh, transport ekspres, prenotim çarter dhe organizim të plotë të transportit nga ajri, deti, toka.

Më poshtë po ju listojmë disa agjenci specicioni që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Tiranë.

## Shoqëri Specicioni

### Shega Trans

Rr. Tefta Tashko nr.10  
Tel.: +355 42 255 008 / 255 009  
Fax: +355 42 255 010  
E-mail: [info@shega-trans.com](mailto:info@shega-trans.com)  
Internet: [www.shega-trans.com](http://www.shega-trans.com)

### AGS Tirana Worldwide Movers

Ish Kombinati Tekstil  
Tel.: +335 42 352 560 / 352 190  
Fax: +355 42 352 560 / 352-190  
E-mail: [agstirana@icc-al.org](mailto:agstirana@icc-al.org)  
Internet: [www.ags-worldwide-movers.com](http://www.ags-worldwide-movers.com)

### DHL

Rr. Donika Kastrioti  
Tel. +355 42 227 667 / 232 816  
Fax.+355 42 257294  
E-mail: [dhlalbania@dhl.com](mailto:dhlalbania@dhl.com)  
Internet: [www.dhl.com](http://www.dhl.com)

### UPS

Rr. Pjetër Bogdani  
Tel.: +355 4 259 742  
Fax: +355 4 259 743  
Cel: +355 68 20 48 904  
E-mail: [mnshafiq@unitrans.com.al](mailto:mnshafiq@unitrans.com.al)  
Internet: [www.ups.com](http://www.ups.com)

## MJEDISI I BIZNESIT

### Transferimi i të dhënave dhe komunikacioni

Transferimi i të dhënave në Tiranë me anë të internetit është shumë i lehtë. Sistemet e transferimit të të dhënave në mënyrë elektronikë janë nga më modernet dhe të gjitha llojeve.

Lidhja me internet në gjithë territorin e qytetit është plotësisht e mundur. Ekzistojnë disa internet provider në Tiranë: [www.abissnet.al](http://www.abissnet.al); [www.abcom-al.com](http://www.abcom-al.com); [www.interalb.net](http://www.interalb.net); [www.albaniaonline.net](http://www.albaniaonline.net).

Përveç telefonit fikse në Tiranë operojnë tre kompani të telefonisë celulare.

Amc ([www.amc.al](http://www.amc.al));  
Vodafone ([www.vodafone.al](http://www.vodafone.al));  
Eagle – Mobile ([www.eaglemobile.al](http://www.eaglemobile.al)).

Sigurimi i një karte SIM në mënyrë që të keni numrin tuaj në Shqipëri ju merr vetëm disa minuta kohë. Ju mund të paraqiteni pranë dyqaneve Vodafone, AMC ose Eagle-Mobile së bashku me mjetin tuaj të identifikimit dhe do të regjistroheni duke përfituar kështu një kartë SIM.

## Furnizimi me energji elektrike, ujë dhe ndotja e ajrit

OSSH, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, i cili furnizon me energji elektrike rreth 1 milion klientë, do të privatizohet se shpejti pasi kompania energjetike çeke CEZ ka fituar tenderin për të blerë 76% të OSSH-se për 102 milion Euro.

Në pesë vitet e ardhshëm CEZ do të investojë 200 milion Euro në kompaninë shqiptare. Me gjithë disa kufizime që mund të ketë ende në furnizimin me energji elektrike Tirana si motori më i madh zhvillues i ekonomisë shqiptare është më e privileguara në këtë drejtim në krahasim me qytetet e tjera të vendit. Aktualisht situata energjetike në Shqipëri është përmirësuar ndjeshëm duke bërë të mundur furnizimin e të gjitha bizneseve që operojnë në Tiranë 24 orë në ditë me energji elektrike.

Ujësllësi i Tiranës, ([www.uktsha.com](http://www.uktsha.com)) një shoqëri anonime, është i vetmi furnizues me ujë i qytetit. Cilësia e ujit nuk është shqetësuese por sasia mbetet problem.

Përgjithësisht Tirana ka furnizim të kënaqshëm, por problemi është vazhdimësia e furnizimit gjatë 24 orëve.

Bizneset e mëdha prodhuese furnizohen me sasinë e nevojshme të ujit sipas kërkesave të tyre. Megjithatë që ta zgjidhin këtë problem ata duhet të nënshkruajnë një kontratë me Ujësllësin e Tiranës. Sipas ligjit Nr. 8435, datë 28.12.1998 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë" operatorët e burimit të ndotjes paguajnë taksë shkarkimesh sipas sasisë dhe tipit të ndotësve të shkarkuar në ajër.

## Cilësia e shërbimit shëndetësor

Shërbimi shëndetësor shtetëror ofron kushtet bazë të shërbimit shëndetësor, por si në çdo fushë tjetër dhe në shëndetësi sipërmarrja private vazhdon të jetë e përqendruar bindshëm në kryeqytet. Në Tiranë operojnë dhjetëra klinika private me qindra mjekë, të cilët ofrojnë shërbime dhe kushte bashkëkohore.

## Hotele dhe apartamente në Tiranë

Në Tiranë operojnë shumë agjenci imobiliare të cilat mund t'ju ndihmojnë për të marrë me qira apo për të blerë ndonjë banesë. Tabela 5 tregon çmimet mesatare për blerjen apo marrjen me qira të apartamenteve në qendër dhe në rrethinat e Tiranës.

Çmimi i apartamenteve	€/m <sup>2</sup>
Në qendër	750 - 2.000
Në periferi	400 - 600
Qiraja e apartamenteve	€/m <sup>2</sup> /muaj
Në qendër	3 - 5
Në periferi	2 - 3

Tabela 5 : Çmimet e përafërta të apartamenteve në Tiranë, për 2009-ën.

Të gjitha transaksionet mbi pasuritë e paluajtshme që nga 1 Janari 2008, do të tatonen me 10% të diferencës midis çmimit të blerjes me atë të shitjes. Shoqëritë e ndërtimit përjashtohen nga ky ligj në momentin e shitjes.

Informacionin e nevojshëm, nëse preferoni të akomodoheni pranë një prej hoteleve të shumtë të Tiranës, mund ta gjeni pranë agjencive turistike ose në guidat turistike si Tirana in Your Pocket ([www.inyourpocket.com](http://www.inyourpocket.com)).

Shumica e hoteleve këtu në Tiranë kanë faqet e tyre të internetit dhe mund të prentoni online në ([www.gjithetyeti.com](http://www.gjithetyeti.com)).

#### Komunitetet ndërkombëtar

Në Tiranë kanë selitë e tyre shumica e organizatave ndërkombëtare dhe bizneseve të huaja të vendosura në Shqipëri.

Mijëra të huaj të punësuar në këto organizata apo në bizneset e tyre jetojnë në metropolin e Tiranës.

Këta të huaj takohen shpesh me njëri-tjetrin dhe marrin pjesë në aktivitete të ndryshme sociale ose që kanë lidhje me biznesin.

#### Shkollat

Në Tiranë ekzistojnë të gjitha nivelet e shkollave duke filluar nga sistemi parashkollor deri në atë pasuniversitar duke arritur një numër prej 247 institucionesh arsimore.

Për çdo nivel të sistemit arsimor ju mund të zgjidhni ndërmjet institucioneve arsimore shtetërore ose atyre private.



Arsimimi në institucionet shtetërore deri në nivelin e mesëm është pa pagesë, ndërsa ndjekja e universitetit bëhet kundrejt një takse prej 15.000 - 80.000 Lek/vit akademik ose 120 - 640 €/vit akademik (sipas fakulteteve, degëve) ndërsa tarifa e akomodimit është 20.000 - 25.000 Lek ose 160 - 200 €uro

Arsimimi në institucionet private bëhet kundrejt tarifave të vendosura prej tyre që variojnë nga 2000 - 5000 €/vit.

Në qershor 2007, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin e ri Nr. 9741 datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" i cili ka si qëllim të përcaktojë misionin, objektivat kryesore të arsimit të lartë dhe të rregullojë aspekte të krijimit,

organizimit, drejtimit, administrimit, financimit, sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me standardet evropiane, si dhe rolin e shtetit dhe të shoqërisë në arsimin e lartë.

Në Tiranë ka një sërë shkollash ndërkombëtare si Tirana International School ([www.qsi.org](http://www.qsi.org)), the Memorial International School ([www.mistedu.com](http://www.mistedu.com)), the Albanian - American Protagonist Elementary School, Shkolla e Mesme Shqiptaro-Franceze "Viktor Hugo", the Harry Fultz Technical School and College ([www.harryfultz.edu.al](http://www.harryfultz.edu.al)) etj.

#### Koha e lirë

Megjithëse Tirana ofron një numër të kufizuar atraksionesh, ajo është një qytet i këndshëm dhe dinamik.

Tirana in Your Pocket në internet ([www.inyourpocket.com](http://www.inyourpocket.com)) dhe si broshurë ofron një vështrim të plotë të atraksioneve, hoteleve si dhe restoranteve dhe bareve në dhe përreth Tiranës.

Ata që janë të interesuar për kulturë mund të vizitojnë Muzeun Arkeologjik, Galerinë Kombëtare të Arteve, Muzeun Historik Kombëtar si dhe Muzeun e Shkencave të Natyrës.

Gjatë shëtijes suaj nëpër qytet, një pjesë e historisë do t'ju shoqërojë në monumentet historike si Xhamia e Et'hem Beut (1789) dhe Kulla e Sahatit (1830), të cilat janë dhe simbolet e Tiranës, ose të merrni pak ajër të pastër dhe të çlodheni pranë Parkut të Madh të Tiranës apo në Parkun Kombëtar të Dajtit ku tani mund të shkohet edhe me një teleferik të ndërtuar nga një firmë austriake ([www.dajti.com](http://www.dajti.com)).

Parku i Madh i Tiranës është një vend shumë atraktiv për ajrin e pastër që ofron, i krahasueshëm me bukurinë e Parkut Kombëtar të Dajtit.

Nuk do të mbesin pa ju tërhequr vëmendjen pallatet shumëngjyrëshe nga të cilat Tirana mori emrin "Qyteti i ngjyrave", si dhe kafenetë e restorantet e shumta, ku do të mund të shijoni gatimet e kuzhinës tradicionale shqiptare dhe asaj ndërkombëtare.

Gjëja më e mirë në Tiranë megjithatë është komunikimi me qytetarët e saj, të cilët gjithnjë gjejnë kohë për të biseduar duke pirë kafe. Nuk është e vështirë të shijosh stilin e jetës alla tirançe.

Duke filluar nga maji i vitit 2007 ka hyrë në fuqi ligji anti-duhan i cili ndalon përdorimin e tij në ambiente publike.

#### Ndihmë dhe konsulencë në Tiranë

Institucionet e mëposhtëm ofrojnë konsulencë dhe kontakte për ata që kanë nevojë për më shumë informacion se si të investojnë në Tiranë.

#### Drejtoria e Promovimit të Qytetit, Bashkia e Tiranës

Adresa: Rr. "Ded Gjo Luli"  
Tel.: +355 42 22 33 13  
Cel.: +355 69 20 63 169  
E-mail: [contactled@tirana.gov.al](mailto:contactled@tirana.gov.al)  
Internet: [www.tirana.gov.al](http://www.tirana.gov.al)

Drejtoria e Promovimit të Qyteti është e gatshme t'iu dërgojë më shumë informacion për kompani dhe institucione të tjera që mund t'iu vinë në ndihmë.

#### Agjencia Shqiptare Biznesit dhe Investimeve (Albinvest)

Blv. Zhan d'Ark, Pall. Shallvareve  
Tel. +355 4 2 252 896 / 2252 976  
E-mail: [info@albinvest.gov.al](mailto:info@albinvest.gov.al)  
Internet: [www.albinvest.gov.al](http://www.albinvest.gov.al)

#### Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë

Rr. Kavajës  
Tel. +355 42 230 284  
Fax +355 42 227 997  
E-mail: [ccitr@abissnet.com.al](mailto:ccitr@abissnet.com.al)  
Internet: [www.cci.gov.al](http://www.cci.gov.al)

#### Dhoma Amerikane e Tregtisë

Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit  
Tel. +355 4 2259 779  
E-mail: [info@amcham.com.al](mailto:info@amcham.com.al)  
Internet: [www.amcham.com.al](http://www.amcham.com.al)

#### Dhoma e Tregtisë Shqiptaro-Britanike

Rr. Brigada VIII  
Tel. +355 4 2371 618 / 2377 056  
Fax +355 4 2342 344  
E-mail: [info@abccci.com](mailto:info@abccci.com)  
Internet: [www.abccci.com](http://www.abccci.com)

#### Dhoma e Tregtisë Italo-Shqiptare

Rr. Nikolla Tupe  
Tel / Fax. +355 4 2257 355

#### Këshillësia e Tregtisë së Jashtme Ambasada Turke Tiranë

Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit; Kompleksi Green Park; Kulla 2, Kati VI, No 20.  
Tel. +355 4 2271 927  
Tel / Fax. +355 4 2256 548  
E-mail: [dmt\\_tiran@yahoo.co](mailto:dmt_tiran@yahoo.co)  
E-mail: [dmt\\_tiran@lykos.com](mailto:dmt_tiran@lykos.com)

#### Qendra Shqiptare e Informacionit të Biznesit (Albic)

Rr Ismail Qemali  
Tel.: +355 4 2 253 352  
E-mail: [info@albic.net](mailto:info@albic.net)  
Internet: [www.albic.net](http://www.albic.net)

#### Market Research (Idra)

Rr. Ismail Qemali  
Tel.: +355 4 2 253 352  
E-mail: [idra@albic.net](mailto:idra@albic.net)  
Internet: [www.idra-al.org](http://www.idra-al.org)

#### Albanian Guarantee Agency

Rr. Ismail Qemali  
Tel.: + 355 42 247 048  
E-mail: [adabulla@icc.al.eu.org](mailto:adabulla@icc.al.eu.org)  
Internet: [www.angelfire.com/al/ashg](http://www.angelfire.com/al/ashg)

## Faqet e mëposhtme të internetit kanë informacion në gjuhën shqipe dhe angleze:

### Institucione shtetërore

Presidenca [www.president.al](http://www.president.al)  
Parlamenti [www.parlament.al](http://www.parlament.al)

### Qeveria

Këshilli i Ministrave [www.km.gov.al](http://www.km.gov.al)  
Ministria e Integritetit [www.mie.gov.al](http://www.mie.gov.al)  
Ministria e Punëve të Jashtme [www.mfa.gov.al](http://www.mfa.gov.al)  
Ministria e Mbrojtjes [www.mod.gov.al](http://www.mod.gov.al)  
Ministria e Financave [www.minfin.gov.al](http://www.minfin.gov.al)  
Ministria e Brendshme [www.moi.gov.al](http://www.moi.gov.al)  
Ministria e Arsimit dhe Shkencës [www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al)  
Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit [www.mbu.gov.al](http://www.mbu.gov.al)  
Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve [www.mtrks.gov.al](http://www.mtrks.gov.al)  
Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta [www.mpcs.gov.al](http://www.mpcs.gov.al)  
Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacioni [www.mpptt.gov.al](http://www.mpptt.gov.al)  
Ministria e Drejtësisë [www.justice.gov.al](http://www.justice.gov.al)  
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës [www.minek.gov.al](http://www.minek.gov.al)  
Ministria e Shëndetësisë [www.moh.gov.al](http://www.moh.gov.al)  
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave [www.moe.gov.al](http://www.moe.gov.al)

### Administratë dhe Shoqëri Civile

Këshilli i Lartë i Drejtësisë [www.kld.al](http://www.kld.al)  
Prokuroria e Përgjithshme [www.pp.gov.al](http://www.pp.gov.al)  
Avokati i Popullit [www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)  
Gjykata e lartë [www.gjykataelarte.gov.al](http://www.gjykataelarte.gov.al)  
Gjykata kushtetuese [www.gjk.gov.al](http://www.gjk.gov.al)  
Kontrolli i lartë i shtetit [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)  
Komisioni qendror i zgjedhjeve [www.cec.org.al](http://www.cec.org.al)

### Institucionet Ndërkombëtare

FMN [www.imf.org](http://www.imf.org)  
PNUD [www.undp.org.al](http://www.undp.org.al)  
OSCE [www.osce.org/albania](http://www.osce.org/albania)  
USAID [www.usaid.gov/regions/al](http://www.usaid.gov/regions/al)  
SNV [www.snvworld.org](http://www.snvworld.org)

### Udhëtimi

Aeroporti Nënë Tereza [www.tirana-airport.com](http://www.tirana-airport.com)  
Albanian Airlines [www.albaniairlines.com.al](http://www.albaniairlines.com.al)  
Alitalia [www.alitalia.it](http://www.alitalia.it)  
Austrian Airlines [www.aua.com/al](http://www.aua.com/al)  
British Airways [www.ba.com](http://www.ba.com)  
Malev [www.malev.com](http://www.malev.com)  
Lufthansa [www.lufthansa.com](http://www.lufthansa.com)

### Agjenci Udhëtimi

Albania Holidays [www.albania-holidays.com](http://www.albania-holidays.com)  
Albtour Guide [www.albanian-tourism.com](http://www.albanian-tourism.com)  
Albanian Experience [www.albanianexperience.com](http://www.albanianexperience.com)  
Venus Travel & Tours [www.travelvenus.com](http://www.travelvenus.com)

### Hotel

Sheraton Tirana Hotel & Towers [www.starwordhotels.com](http://www.starwordhotels.com)  
Rogner Europapark [www.hotel-europapark.com](http://www.hotel-europapark.com)  
Tirana International [www.tiranainternational.com](http://www.tiranainternational.com)

### Agjenci Imobiliare

Colliers International [www.colliers.com](http://www.colliers.com)  
Dev Informacion [www.devinf.com](http://www.devinf.com)  
Inf 93 [www.inf-93.com](http://www.inf-93.com)  
Balkimo [www.balkimo.com](http://www.balkimo.com)  
Tirana Inf [www.realestate.com.al](http://www.realestate.com.al)

### Makina me qira

Avis [www.avisalbania.com](http://www.avisalbania.com)  
Europcar [www.europcar.com](http://www.europcar.com)  
Hertz [www.hertz.com](http://www.hertz.com)

### Agjenci sigurimesh

Insig [www.insig.com.al](http://www.insig.com.al)  
Sigal [www.albanianinsurance.com](http://www.albanianinsurance.com)  
Sigma [www.sigma-insurance.com](http://www.sigma-insurance.com)

### Bankat

Banka Botërore [www.worldbank.org.al](http://www.worldbank.org.al)  
Banka e Shqipërisë [www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)  
Banka Raiffeisen [www.raiffeisen.al](http://www.raiffeisen.al)  
Intesa Sanpaolo Bank Albania [www.intesasanpaolobank.al](http://www.intesasanpaolobank.al)  
Banka Pro Credit Bank [www.procreditbank.com.al](http://www.procreditbank.com.al)

### Institucione Financiare

Fondacioni Besa [www.besa.org.al](http://www.besa.org.al)  
American Global Capital Fond [www.amerfond.com](http://www.amerfond.com)

### Kontrollor dhe Këshillues

Deloitte Touche [www.dellitte.com](http://www.dellitte.com)  
Kpmg [www.kpmg.com.al](http://www.kpmg.com.al)  
Price Waterhouse Coopers [www.pwc.com](http://www.pwc.com)  
Ernst & Young [www.ey.com](http://www.ey.com)  
ZIG Consulting AL sh.p. [www.zig-al.com](http://www.zig-al.com)

### Zyra avokatie

Kalo & Associates [www.kalo-attorneys.com](http://www.kalo-attorneys.com)  
Boga & Associates [www.bogalaw.com](http://www.bogalaw.com)  
Tonucci & Partners [www.tonucci.it](http://www.tonucci.it)

### Dhoma e Tregtisë

Unioni i dhomave të Tregtisë dhe Industrisë të Shqipërisë [uccial@abisnet.com.al](mailto:uccial@abisnet.com.al)

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë [www.cci.gov.al](http://www.cci.gov.al)

Dhoma Amerikane e Tregtisë [www.amcham.com.al](http://www.amcham.com.al)

Dhoma e Tregtisë Shqiptaro-Britanike [www.abbcci.com](http://www.abbcci.com)

### Shoqëri Spedicioni

Shega Trans [www.shega-trans.com](http://www.shega-trans.com)  
Worldwide Movers [www.ags-worldwide-movers.com](http://www.ags-worldwide-movers.com)  
A&A International [www.aa-group.net](http://www.aa-group.net)

### Transferta Monetare

Wester Union [www.unionifinanciar.com](http://www.unionifinanciar.com)  
Ems [www.postashqiptare.al/ems](http://www.postashqiptare.al/ems)  
Money Gram [www.moneygram.com](http://www.moneygram.com)

### Shoqëri postare

Posta Shqiptare [www.postashqiptare.al](http://www.postashqiptare.al)  
Dhl [www.dhl.com](http://www.dhl.com)  
Ups [www.ups.com](http://www.ups.com)  
Fedex [www.fedex.com.al](http://www.fedex.com.al)  
Sky net [www.skynetwwe.com](http://www.skynetwwe.com)  
Albanian Courier [albanian.courier@albiancourier.al](mailto:albanian.courier@albiancourier.al)

### Universitetet

Magjistratura [www.magjistratura.edu.al](http://www.magjistratura.edu.al)  
Universiteti Tiranës [www.unitir.edu.al](http://www.unitir.edu.al)  
Universiteti i New York-ut [www.unyt.edu.al](http://www.unyt.edu.al)  
Univeriteti European i Tiranës [www.universitetieuropean.com](http://www.universitetieuropean.com)  
Universiteti Kristal [www.universitetikristal.edu.al](http://www.universitetikristal.edu.al)  
Universiteti Luarasi [www.luarasi-univ.edu.al](http://www.luarasi-univ.edu.al)  
Universiteti Ufo [www.ufouniversity.al](http://www.ufouniversity.al)  
Universiteti Marin Barleti [www.umb.edu.al](http://www.umb.edu.al)  
Universiteti Polis [www.universitetipolis.org](http://www.universitetipolis.org)  
Universiteti Zoja e Këshillit të Mirë [www.unizkm.edu.al](http://www.unizkm.edu.al)  
Politekniku [www.upt.al](http://www.upt.al)  
Universiteti Bujqësor i Tiranës [www.ubt.edu.al](http://www.ubt.edu.al)  
Akademia e Arteve [www.academiearteve.edu.al](http://www.academiearteve.edu.al)  
Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi" [www.afmm.edu.al](http://www.afmm.edu.al)  
Universiteti Iliria [www.uni-illyria.com](http://www.uni-illyria.com)

### Aktivitetet

Kinema Millennium [www.ida-millennium.com](http://www.ida-millennium.com)  
Kinema Imperial [www.empire-al.com](http://www.empire-al.com)

### Burime të tjera

Guidë Turistike [www.inyourpocket.com](http://www.inyourpocket.com)  
Harta Turistike e Tiranës [www.tirana.gov.al](http://www.tirana.gov.al)  
Gjithshka mbi qytetin [www.gjitheqyteti.com](http://www.gjitheqyteti.com)  
Gazetat në Internet [www.onlinenewspapers.com/albania](http://www.onlinenewspapers.com/albania)  
Libri telefonik [www.albaniatelephonebook.com](http://www.albaniatelephonebook.com)